

Specialist në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 04 datë 08.01.2024, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Zbatimin me korrektësi të buxhetit të institucionit, sipas zërave të strukturës buxhetore të miratuar si dhe evidenton dhe nxjerr të dhënat mujore dhe progresive mbi bazën e dokumenteve financiare të shpenzimeve;
2. Asistencën në përgatitjen e planit buxhetor afatmesëm për programim, planifikim e menaxhim në përputhje me kërkesat e institucionit bazuar në legjislacionin që rregullon këtë fushë;
3. Mbështetjen dhe asistencën nga pikpamja procedurale dhe financiare projektet që do të zhvillohen brenda vendit si dhe projektet që kërkojnë bashkëpunim me organizata të huaja. Ndjekjen nga ana financiare zbatimin e çdo projekti, si ato të financuara nga buxheti i shtetit dhe ato me financim të huaj;
4. Përpilimin e urdhër-shpenzimeve për blerjet apo shërbimet e kryera dhe paraqitjen e tyre në Degën e Thesarit, për likuidim, mbi bazën e dokumentave justifikuese;
5. Kryerjen rregullisht të rakordimit të të dhënave me Degën e Thesarit dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për përdorimin e buxhetit;
6. Detajimin e fondeve buxhetore të miratuara me ligj për institucionin dhe hartimin e përmbledhëses së detajimit të shpenzimeve korrente dhe kapitale;
7. Përpunimin e të dhënave të llogarive vjetore dhe pasqyrave financiare;
8. Kryerjen brenda afateve të llogaritjeve e shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve, bazuar në dokumentacionin justifikues;
9. Hartimin e listë-pagesave të punonjësve çdo muaj në përputhje me pozicionin e punës së secilit si dhe bërjen e deklarimeve në institucionet përkatëse sipas kërkesave dhe brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

10. Administrimin dhe dokumentimin e lëvizjeve të vlerave monetare dhe hartimin e dokumentacionit përkatës si dhe zbatimin e rregullave të tarifimit, të përcaktuara nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, sipas klasifikimit dhe përkatësisë së tyre në temat e veçanta;
11. Pjesëmarrjen në strukturat e krijuara me urdhër të titullarit për realizimin e prokurimeve publike sipas legjislacionit në fuqi;
12. Pasqyrimin e saktë të evidencës kontabël, në përputhje me planin kontabël dhe ligjin për kontabilitetin e vlerave monetare e materiale;
13. Ofrimin e mbështetjes dhe këshillave për përdorimin e fondeve të institucionit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe për përdorimin e fondeve nga donatorë të huaj, në kuadër të marrëveshjeve të lidhura;
14. Kontributin në realizimin e planit vjetor të institucionit dhe arritjen e objektivave në përputhje me fushën e veprimit të institucionit e veçanërisht të këtij sektori;
15. Menaxhimin e procesit të testimit të tregut, përlllogaritjeve financiare dhe ekzekutimit të kontratave në procedurat e prokurimeve publike;
16. Përgatitjen e materialeve informuese për Përgjegjësin e Sektorit dhe Drejtorin e Drejtorisë lidhur me realizimin e detyrave si dhe rast pas rasti për problematikat e hasura gjatë punës;
17. Kryerjen e çdo funksion të ngarkuar nga eprori, për realizimin e veprimtarisë së sektorit dhe ASIG;
18. Hartimin dhe dërgimin në institucionet përkatëse të regjistrit të realizimit të prokurimeve publike;
19. Përfaqësimin e institucionit me propozim të Drejtorit të Drejtorisë dhe miratim të Drejtorit të Përgjithshëm.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

1. Të këtë mbaruar studimet e larta e të zotërojë diplomë “Master profesional” në Shkenca Ekonomike;
2. Të këtë përvojë pune 1 vit në fushën përkatëse;
3. Të këtë njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politika institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre;
4. Të njohë mirë gjuhën angleze, (njohja e gjuhëve të tjera është prioritet);
5. Të njohë kuadrin ligjor në fuqi për financat, buxhetin dhe prokurimet publike;
6. Të këtë eksperiencën e nevojshme për të mbështetur nga pikëpamja financiare dhe procedurale projektet që zhvillohen si brenda vendit ashtu edhe me organizma të huaja;
7. Të njohë programet kompjuterike bazë dhe programet që lidhen me

kontabilitetin;

8. Të zotërojë aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe pune në grup.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-2)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 26.07.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit burime.njerezore@asig.gov.al këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.

Pas datës 26.07.2024, aplikantët të cilët kalojnë fazën e parë të vlerësimit, do të njoftohen me e-mail për datën dhe orën e zhvillimit të intervistës.